



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Lënda : Analiza e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kuçovë për periudhën Janar – Prill 2016.

Në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2 , datë 06. 02. 2012,“ Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, si dhe Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 15/01/2016, të Ministrisë së Financave; “ Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2016, më poshtë po japim një përmbledhje të ecurisë së zbatimit të buxhetit të vitit 2016 për Bashkinë Kuçovë dhe institucionet në varësi për periudhën: Janar – Prill.

Drejtoria e Financës e organizon punën e saj sipas ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, “ Për Vetëqeverisjen Vendore”. Duke filluar nga muaji Janar e në vazhdim është punuar për zbatimin me korrektësi të V.K.Bashkiak Kuçovë nr. 06 dt. 31.01.2016 “Për Buxhetin e Bashkisë Kuçovë për vitin 2016” të konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 167/1 dt 10.02.2016 “ Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kuçovë për vitin 2016”.

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, u detajua buxheti për vitin 2016 për Bashkinë dhe institucionet në varësi.

-Të ardhurat e Bashkisë për periudhën Janar- Prill 2016:

Në lekë

PERIUDHA	Plani vjetor	Fakt 4- mujor	Bashkia	Nj. A Perondi	Nj. A Lumas	Nj. A Kozare
JANAR – PRILL VITI 2016	201,100,000	40,189,903	29,651,660	4,909,958	1,686,436	3,901,849

Planifikimi për 4 mujorin është 66,700 mijë lekë, fakti është 40,189 mijë lekë, realizimi 60.25%.

-Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Prill 2016:

Më poshtë jepet realizimi i shpenzimeve në periudhën Janar- Prill 2016, krahasuar me planin vjetor për Bashkinë dhe institucionet në varësi:

në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga		Shpenzimet operative				Investimet		F. emergjence	Te Tjera	
		Plan	Fa kt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Fakt	Plan	Fakt
1	Bashkia	8 1,233	21, 69 1	13, 161	3,5 92	32,173	3,06 8	7,242	24 2		7,455	694
2	Shërbimet Publike					51,813	6,85 4	51,758	21,59 6			
3	Qendra Ekonomike e Arsimit	7 4,180	23, 02 7	12,492	3,8 56	19,237	5,96 0	140	36		10,30 8	4,107
4	Qendra Kulture	3,910	67 7	660	1 13	2,294	52 9	360				
5	Mirëmbajtje Rrugë&Trotuare	2 0,549	5,3 84	3,448	8 96	33,304	8,02 5	1,070			50	
	TOTAL	179,872	50, 77 9	29,760	8,4 57	138,821	24,43 6	60,570	21,87 4	-	17,81 3	4,801

Tabela e mësipërme pasqyron faktin e shpenzimeve gjate 4-mujorit te pare te vitit 2016 kundrejt planit vjetor.

Nga tabela rezulton se në total fondet e veta, janë realizuar në fakt në shumën 110,347 mijë lekë ndërsa fondet e planifikuara vjetore jane në shumën 428,336 lekë, realizimi i fondeve 25.76%.

Realizimi i fondeve plan – fakt, për Bashkinë Kuçovë është 20.51%, për Shërbimet Publike realizimi i fondeve është 27.47%, për Qendrën Ekomonike të Arsimit 31.79%, për Qendrën Kulture 18.25% dhe për Ndërmarjen Komunale 24.49%.

Në nivel artikulli realizimi i fondeve në total rezulton si më poshtë:

-Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 28 % të planit vjetor, po kështu edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 28 % kundrejt planit vjetor.

-Shpenzimet operative janë likuaduar në masën 18% të planit të përgjithshëm vjetor.

-**Investimet** janë likuajduar në masën 36% të kontratave të çelura në sistemin e thesarit. Nga të cilat për pajisje zyre janë likuajduar në masën 3% të planit të përgjithshëm vjetor. Shpenzimet e kryera për investime për shërbimet publike realizuar në masën 42%, konkretisht janë likuajduar shpenzimet për rikonstruksionin e rrugës Kristaq Laçka në shumën 13,599,709 lekë investim i cili ka përfunduar dhe është likuajduar plotësisht si dhe likuajdimi i shpenzimeve për rikonstruksionin e KUZ në Lagjen 1 Maj në shumën 7 milionë lekë, investim i cili është duke përfunduar.

-**Shpenzimet e tjera** janë realizuar në fakt 27%. Në këtë zë përfshihen shpenzimet e kryera për transferta që kryhen për agjentë tatimorë, ndihma ekonomike për rastet e veçanta të Bashkisë, ndihmë për raste fatkeqsish, shpërbllim për dalje në pension pleqërie dhe transferta për KF Naftëtari.

Më poshtë jepet realizimi i shpenzimeve në periudhën Janar- Prill 2016, krahasuar me planin 4 Mujor për Bashkinë dhe institucionet në varësi:

në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga		Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative		F. emergjence				Te Tjera	
		Plan	Fakt	Plan	Fa kt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Pla n	Fakt
1	Bashkia	27,078	21,691	4,387	3,592	10,724	3,068	7,242	242	1,500	0	7,455	694
2	Shërbimet Publike					17,271	6,854	51,758	21,596	0	0		
3	Qendra Ekonomike e Arsimit	24,727	23,027	4,164	3,856	6,412	5,960	140	36	0	0	10,308	4,107
4	Qendra Kulturore	1,303	677	220	113	765	529	360		0	0		
5	Mirëmbajtje Rrugë&Trotare	6,850	5,384	1,149	896	11,101	8,025	1,070		0	0	50	
	TOTAL BASHKIA KUÇOVË	59,957	50,779	9,920	8,457	46,274	24,436	60,570	21,874	1,500	0	17,813	4,801

Nga tabela rezulton se në total fondet e veta, janë realizuar në fakt në shumën 110,347 në mijë lekë ndërsa fondet e planifikuara si kater mujor jane në shumën 196,034 lekë, realizimi i fondeve 56.29%.

Në nivel artikulli realizimi i fondeve, rezulton si më poshtë:

-**Shpenzimet për paga** janë realizuar në masën 85 % të planit kater mujor, po kështu edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 85 % .

-**Shpenzimet operative** janë likuajduar në masën 53% të planit të kater mujor.

-**Shpenzimet e tjera** janë realizuar në fakt 27%.

1. **Për Bashkinë** realizimi i fondeve në nivel artikulli rezulton si më poshtë:

Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 27% të planit vjetor, po kështu edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 27 % , ndërsa kundrejt planifikimit per 4 Mujorin e I-re 2016 shpenzimet për paga janë realizuar në masën 80% të planit dhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 82 % kundrejt planit. Mosrealizimi në këtë zë shpenzimesh vjen për shkak të vendeve të punës që kanë qënë vakante.

-**Shpenzimet operative** janë likuajduar në masën 10% të planit të përgjithshëm vjetor dhe 29% te planifikimit per 4 Mujorin e pare. Shpenzimet operative në total janë realizuar 2,968,387 lekë.

Në këtë zë përfshihen shpenzimet operative të kryera për funksionimin e aparatit, si:

- Shpenzime për shërbime nga të tretë (ujë, energji elektrike, telefon-internet) realizuar në vlerën 468,578 lekë.

- Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit, realizuar në vlerën 52 000 lekë.

Pl 4 muj	Qendra Ekonomike e Arsimit	24,727	23,027	4,164	3,856	6,412	5,960	36	36	4,110	4,107
Pl. Vjetor	Qendra Ekonomike e Arsimit	74,180	23,027	12,492	3,856	19,237	5,960	140	36	10,308	4,107

Realizimi i shpenzimeve operative:

Se pari puna eshte perqendruar ne likujdimin e detyrimeve per sherbimet me te tretet ne zerat uje , energji , telefon , duke mos lene asnje fature te pashlyer, në mënyrë që të shmangët rritja artificiale e detyrimeve për shkak të kamatvonesave.

- Vlera totale e energjise:1 185 996 leke.
- Vlera totale e faturave te ujit: 755 588 leke.
- Vlera totale e faturave te telefonit: 18 248 leke.

Se dyti janë zbatuar shtesat e kontratave per furnizimin normal me ushqime per femijet në kopshte e çerdhe , detergjente , karburant dhe sherbime per ngrohje dhe janë bere likujdimet totale te tyre brenda ketij katermujori.

- Vlera totale e furnizimit me produkte ushqimore:1 350 522 leke.
- Vlera totale e faturave te detergjenteve:139 800 leke.
- Vlera totale e faturave te sherbimeve per ngrohje: 1 265 093 leke.

Se treti theksojme se gjate dy muajve te pare te vitit bazuar ne proceduren e blerjeve te vogla elektronike janë furnizuar shkolla, kopshte etj, me dru zjarri dhe karburant, shpenzime që do të likujdohen ne vazhdimesi.

- Vlera totale e furnizimit me dru zjarri: 960 000 leke.
- Vlera totale e furnizimit me karburant: 687 146 leke.

Se katerti eshte kryer transferta per KF Naftetari sh.a ne vleren 4 000 000 leke , te realizuar ne masen 40% mbi planin e vitit 2016.

Ka patur një funksionim normal në furnizimin me ushqime, materiale pastrimi e të tjera për kopshtet e çerdhet në përputhje si me nevojat ashtu edhe me shpenzimet e planifikuara në buxhetin vjetor.

3.Për Drejtorinë e Shërbimeve Komunale, buxheti i planifikuar dhe realizuar paraqitet në tabelën në vijim:

Në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga		Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative	Investimet		Te Tjera	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt		Fakt	Plan	Fakt	Plan
Pl 4 muj	Mirëmbajtje Rrugë&Trotuare	6,850	5,384	1,149	896	8025	268		50	
Pl. Vjetor	Mirëmbajtje Rrugë&Trotuare	20,549	5,384	3,448	896	8,025	1,070		50	

Ky institucion ka përgjegjesinë për mirëmbajtjen e objekteve shkollore, kopshteve, çerdheve, rrjetit të ndriçimit, rrjetit hidraulik, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit rrugor, mirëmbajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbra etj.

1. Fondi i Pagave është realizuar 79% të planit 4 mujor dhe 26 % të planit vjetor, po në këto shifra rezultojnë edhe sigurimet shoqërore, shpenzimet operative janë realizuar 72 % e shpenzimeve të planifikuara për 4 mujorin e parë.

3.Shpenzimet operative; të planifikuara rezultojnë 11,101 mijë lekë, realizimi i fondeve është në vlerën 8,025 mijë leke ose 72 % e buxhetit të planifikuar për katër mujorin e parë.

Peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative të kryera e zënë shpenzimet për energjinë e ndriçimit rrugor në vlerën 6,986,664 lekë.

- Shpenzimet për mirëmbajtje të zakonshme të objekteve shkollore (në kopshtin nr. 1 dhe kopshtin nr. 2 është kryer mirembajtje e zakonshme që përfshin riparime të dyersh, ndërrim bravash etj, Kopshti 1 Qershor është lye komplet, Q.K.F lye komplet, shkolla vlashuk është lye komplet, shkolla goraj është lye me boje dhe gelqere, në shkollën 18 tetori është kryer shtrim me beton dhe lye e ambjentëve , në shkollën Koço Korçari dhe 18 tetori është kryer shtrim me beton dhe lye e ambjentëve) e administrative janë realizuar në vlerën 127,030 lekë.

-Shpenzimet për materiale për mirëmbajtjen e rrugëve e trotuareve realizuar në vlerën 546,980 lekë, është ndërhryrë në lagje të ndryshme të qytetit, në njësinë administrative Perondi (konkretisht në Velagosht), në Njësinë Administrative Kozare konkretisht në Zdravë, ku janë vendosur tubo betoni dhe është punuar për sistemimin e kanaleve të ujrave te zeza.

Shpenzime per karburant dhe vaj realizuar 144,979 leke.

Shpenzime per ujë 22 014 leke.

Shpenzime për telefon dhe internet 21,068 leke.

Miratimi me vonesë i buxhetit dhe afatet e procedurave të prokurimit kanë shkaktuar vonesa në furnizimin normal të kësaj njësie në muajt e parë të vitit, deri tani është lidhur kontrata për furnizim me karburant e vaj dhe është punuar me shtesë kontrate për materialet e ndërtimit. Janë në process prokurimi tenderat për blerjen e materialeve të ndërtimit dhe materialeve elektrike.

4. **Për Qendrën Kulturore**, në mënyrë të përmbledhur planifikimi dhe realizimi i fondeve është si vijon:

Në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga		Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative		Investimet	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	i Njësisve Vendore								
Pl. Vjetor	Qendra Kulturore	3,910	677	660	113	2,294	529	360	0
Pl. 4-mujor	Qendra Kulturore	1,303	677	220	113	765	529	360	0

Për Qendrën Kulturore, realizimi i fondit të pagave është 52% , sigurimeve shoqërore rezulton i realizuar 51%, kundrejt planit 4 mujor, shpenzimet operative janë realizuar në masën 23% e planit vjetor. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në masën 52% vjen për shkak të vendeve vacant pranë këtij institucioni dhe se pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e Qendrës Rinore janë paguar nga Bashkia deri në momentin e miratimit të buxhetit për vitin 2016.

Peshën më të madhe të shpenzimeve operative e zënë aktivitetet kulturore, të cilat janë kryer sipas planifikimit në buxhet.

Shpenzimet për aktivitetet kulturore të likujduara në vlerën 455,650 lekë i përkasin aktiviteteve si “ Dita e Verës”, Dita Botërore e Librit për fëmijë dhe të rritur përkatësisht në datat 2 dhe 23 Prill dhe aktiviteti i organizuar në kinemanë e qytetit për “ Ditët e filmit Spanjoll” ku u sigurua hyrje e lire për të gjithë të apasionuarit pas filmit.

Shpenzime të tjera si ujë, telefon , internet në shumën 63,296 lekë dhe shpenzime për abonim shtypi në vlerën 3,614 lekë.

Të gjitha shpenzimet e kryera janë sipas planifikimit në buxhet.

Theksojmë se, janë hasur vështirësi për funksionimin normal të punës në ndërmarjen komunale, PMNZSH dhe bordin e Ujitjes dhe Kullimit për shkak të miratimit me vonesë të buxhetit dhe procedurave të prokurimit (të cilat janë detyrime ligjore).

Shkak për mos likujdimin e shpenzimeve operative dhe investimeve të kryera ka qënë pamjaftueshmëria e fondeve si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave të planifikuara, të cilat nuk janë realizuar në nivele të kënaqshme por edhe parregullsive në dokumentacionin justifikues.

- Në muajin Mars është mbyllur llogaria vjetore e institucionit e konsoliduar me tre njësitë Administrative dhe është depozituar në thesar, konformë dispozitave ligjore në fuqi.

Dr.Finance&Buxheti
Heroina Shkempi